# DËSHMI ARKIVI

**A-476498**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Partitë pa marrëveshje për presidentin e ri teksa afati po soset |
| ADRESA | `https://dosja.al/aktualitet/partite-pa-marreveshje-per-presidentin-e-ri-teksa-afati-po-soset-i516530` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 13:43:33 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 13:37:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 2f266ebaa77ba1d096ad915c76b2203b7450ea6d337f1071967ad613c7aaf0cd |
| TEKSTI | daa6c60e36a939aa62186eb184e1315443bc91d1e0834f29122f3312a5e836ec |
| PAMJA | 1b5952489424fe8a37067e8b1010cc9d33fe9ef5aa09ecb7d420d2acf777930b |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 51aa0b5f22cb0ed948dcfbefe54f42750fb6878a7e3e0084137eb045d2bb9bb3 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 282274d0ff18f09ea4854e79728659ffe2d6cd028bfa2085cb95da6ce0a699bb |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/51aa0b5f22cb0ed948dcfbefe54f42750fb6878a7e3e0084137eb045d2bb9bb3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Aktualitet

# Partitë pa marrëveshje për presidentin e ri teksa afati po soset

Në një aktgjykim të 23 shtatorit, Gjykata Kushtetuese e Kosovës sqaroi se afati 60-ditor për zgjedhjen e presidentit ka nisur më 8 gusht, nga dita kur u konstituua Kuvendi, dhe përfundon më 6 tetor.

dosja
28 Shtator 2026, 15:37
Nga G.M



Parlamenti i Kosovës dhe ndërtesa e Presidencës

Partitë parlamentare ende nuk janë përcaktuar për një emër të cilin do ta mbështesnin për president të ardhshëm të Kosovës, pavarësisht se një afat kushtetues për zgjedhjen e presidentin mbaron kah fundi i javës së ardhshme.

Në një aktgjykim të 23 shtatorit, Gjykata Kushtetuese e Kosovës sqaroi se afati 60-ditor për zgjedhjen e presidentit ka nisur më 8 gusht, nga dita kur u konstituua Kuvendi, dhe përfundon më 6 tetor. Për këtë çështje kryetari i Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), Bedri Hamza bisedoi të dielën me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurtin.

Hamza u tha të hënën gazetarëve se në atë takim ku u shtjelluan edhe tema tjera të situatës politike, biseduan për çështjen e presidentit pa folur rreth emrave konkretë për këtë pozitë. Ai tha se partia e tij është e gatshme të diskutojë më tutje çështjen e presidentit me Lëvizjen Vetëvendosje, nëse miratohet projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë.

*"Nuk kemi shkuar për emrat, nuk i kemi folur, nëse kalohet ligji jemi të hapur edhe për tema tjera"*, tha ai.

Për momentin ky projektligj është në Qeveri, tek e cila është dërguar për një mendim më 25 shtator. Që nga 4 prilli, Kosova është me ushtrues detyre të presidentit. Ky funksion, sipas Kushtetutës, nuk mund të ushtrohet më shumë se gjashtë muaj nga ushtruesi i detyrës. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) është shprehur e gatshme për të kontribuuar në zgjidhjen e çështjes së presidentit.

Shefja e Grupit Parlamentar të LDK-së, Jehona Lushaku, tha se partia opozitare ka vullnet për t'i konkretizuar hapa që të zgjidhet secili problem në mënyrë që të funksionojnë të gjitha institucionet.

*"Ne nuk jemi në situatë që mund të themi që jemi pro ose kundër një kandidati. Por jemi të gatshëm që të*

editoriale

Meri Lika
Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Enton Abilekaj
Labirinti i errët i Edi Ramës

Në vëmendje

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 13:36
VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 13:01
FOTOLAJM/ Kush janë dy të rinjtë që tentuan të mashtronin Armand Dukën dhe lidhja me Florian Gjergjin

*kontribuojmë për zgjedhjen e presidentit"*, tha ajo.

Pas bisedimeve mes LVV-së dhe LDK-së së Lumir Abdixhikut, palët arritën një marrëveshje në fund të gushtit për një president konsensual, dhe dy partitë propozuan Bekim Sejdiun.

Megjithatë, një ditë pas njoftimit për marrëveshjen u bë e ditur se gjashtë deputetë të LDK-së nuk e përkrahnin këtë kandidaturë duke bërë që, në praktikë, Sejdiu të mos kishte 81 votat e nevojshme – dy të tretat e Kuvendit me 120 ulëse, që kërkohen për procesin e zgjedhjes së presidentit.

Si pasojë, më 14 shtator Sejdiu u tërhoq nga kandidatura për president për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme për zgjedhjen e tij. Aleanca, e cila përfaqësohet me shtatë deputetë në Kuvend, ka refuzuar të takohet me liderin e LVV-së, Albin Kurtin rreth çështjes së presidentit, teksa kishte paraqitur gjashtë kushte në këmbim të mbështetjes.

Deputeti i kësaj partie, Ramush Haradinaj tha se Kurti "është tallur" me liderët opozitarë në këto takime, pasi sipas tij qëllimi ka qenë shkuarja në zgjedhje.

"I ka ftuar në takime i ka tallur dhe në fund i ka lënë pa marrëveshje", është shprehur Haradinaj para mediave të hënën, duke shtuar se Aleanca "nuk bëhet pjesë e lojërave të Kurtit".

Kosova rrezikon të shkojë drejt zgjedhjeve të reja – që do të ishin të katërtat që nga shkurti i vitit 2025 – nëse partitë nuk gjejnë ujdi që ta zgjedhin kreun e ri të shtetit para afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese./REL

kosova rel

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 11:21

"Nuk mërzitem kurrë me Shqipërinë", Rama ndërpret fjalën e raportuesit për Shqipërinë në PE: Aman, s'i lë dot gjermanët të presin

## më të klikuarat

Labirinti i errët i Edi Ramës

Hakerat iranianë nxjerrin mbi 600 numra të personelit të SHISH-it, publikojnë edhe dokumente konfidenciale

WSJ zbardh prapaskenat: Ja si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të siguronte marrëveshjen 6 mld $ në Shqipëri

I martuar me një grua ruse, si u kap gafil elbasanlliu Salvatore Aliu, që kërkohej nga SPAK

## Sondazh

Poll

## insights

Bledian Koka
Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

## Moti

Powered by tomorrow.io

Aktualitet
28 Shtator 2026, 14:51

## Bie zjarr në fshatin Lalm i Ri në Lezhë, flakët u afrohen banesave

LEZHA- Një zjarr ka rënë ditën e sotme në fshatin Lalm i Ri në Lezhë, i cili ka përfshirë një sip&...

Dyshohet se përdhunoi dhe i vodhi paratë një vajze, shpallet në kërkim 43-vjeçari në Vlorë

Aktualitet
28 Shtator 2026, 14:45

Operacioni 'Barriera'/ Zbulohen gjashtë lokale ku luheshin lojëra fati në Tiranë, në pranga tetë persona (VIDEO)

Aktualitet

28 Shtator 2026, 14:33

Rregullorja e re përçan gjyqtarët/ Kreu i GJKKO mbledh kolegët, por ende nuk arrihet një konsensus

Aktualitet

28 Shtator 2026, 14:25

Arrestohet mësuesi 60-vjeçar në Lushnje, i dërgonte mesazhe me përmbajtje seksuale nxënëses 13-vjeçare

Aktualitet

28 Shtator 2026, 14:21

Aktualitet

28 Shtator 2026, 13:58

# I martuar me një grua Ruse, si u kap gafil elbasanlliu Salvatore Aliu. Kërkohej nga SPAK

Salvatore Aliu Detaje të reja kanë dalë nga operacioni, për kapjen në Rusi të Salvatore alias Shpëtim Aliut në Fede...

VIDEO/ Po qarkullonin me automjetin e vjedhur, në pranga dy persona në Kavajë, rezultojnë me precedentë të mëparshëm penal

Aktualitet

28 Shtator 2026, 13:47

Protesta në Maliq për ujin e pijshëm/ Përplasje mes efektivëve dhe qytetarëve, një protestues humb ndjenjat (VIDEO)

Aktualitet

28 Shtator 2026, 13:26

### Po transportonte emigrantë të paligjshëm drejt Malit të Zi, në pranga 39-vjeçari në Shkodër

Aktualitet

28 Shtator 2026, 13:14

### FOTOLAJM/ Kush janë dy të rinjtë që tentuan të mashtronin Armand Dukën dhe lidhja me Florian Gjergjin

Aktualitet

28 Shtator 2026, 13:01

## MË SHUMË





Protesta në Maliq kundër investimit të Ujësjellësit/ Përplasje mes efektivëve dhe qytetarëve


Tentuan të mashtronin Armand Dukën në emër të Taulant Ballës, në pranga sekserët e Florian Gjergjit


Debati ironik në Komision, Korreshi: Të ndryshohet rendi i ditës i nderuar kryetar


Mashtruan një të moshuar në emër të Armand Dukës, në pranga 2 sekserët e Florian Gjergjit...

## Protesta në Maliq kundër investimit të Ujësjellësit/ Përplasje mes efektivëve dhe qytetarëve

Shiko video te tjera

KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MUNDESUAR NGA Mediadesk

AKTUALITET
POLITIKE
EKONOMI
BOTA
SPORT
ART&ARGËTIM
INSIGHTS
EDITORIAL

**Drejtor: Enton Abilekaj**

**Kryeredaktor: Izmir Akulli**

**Gazetarë:**
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.